



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3301/40 Prot.

Vlorë më, 18.12.2025

VENDIM

Nr. 100, datë 18.12.2025

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 23, DATË 11.03.2025 TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT, PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT NË TË
GJITHA NIVELET NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, gërma ç, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 25 pika 1, gërma ç të Statutit të UV-së; Vendimit të Senatit Akademik nr.123, datë 15.12.2025 "Për propozimin në Bordin e Administrimit të UV-së, një ndryshim në strukturën organizative, numerike dhe organigramën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë" si dhe referuar shkresës së Administratorit të UV-së, me nr. 3275 prot., datë 17.12.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.12.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshim e strukturës organizative, numerike dhe organigramën e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:
 - Sektori i Burimve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit, të shtohet me 1 (një) personel "Specialist Protokollit".
2. Numri i përgjithshëm i personelit ndihmës-akademik dhe administrativ ndryshon në 124 (njëqind e njëzetë e katër).
3. Bashkëlidhur këtij Vendimi, Struktura organizative dhe numerike e UV-së me ndryshimet e miratuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA

